



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2022

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2022

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2023 DHE PROGRAMIT BUXHETOR  
AFATMESEM PERFUNDIMTAR 2023 - 2025 TË BASHKISË SË SHKODRËS**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3 shkronja "c", 34, 40, 41, 54 shkronja "dh" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar ; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-29, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar; projektligjit "Për buxhetin e vitit 2023"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 08 datë 28.02.20212 "Per përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 08.07.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"; Shkreses së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 19206 date 19.10.2022 " Dergohet per njoftim Transferta e Pakushtezuar e Pergjithshme per vitin 2023 " , dhe relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë buxhetin e vitit 2023 dhe programin buxhetor afatmesem përfundimtar për vitet 2023 - 2025, të Bashkisë së Shkodrës, si më poshtë:
  - a) Të miratojë tavanet për çdo program, për vitin 2023 - 2025 të programit buxhetor afatmesëm sipas tabelës 1 të FPT (Instrumentit të Planifikimit Financiar) dhe programeve buxhetore të detajuara , pjesë përbërëse e këtij vendimi.

- b) Të miratojë të ardhurat sipas përputhshmërisë me rregullat fiskale në fuqi dhe shpenzimet e buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme buxhetore dhe tre vitet e ardhshme, sipas tabelës 2 të FPT, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
  - c) Të miratojë detajimin e shpenzimeve sipas klasifikimeve buxhetore për vitet 2022-2024 sipas tabelës 3-5,4,4.1 të FPT dhe programeve buxhetore të detajuara sipas klasifikimit ekonomik, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
  - d) Të miratojë qellimet /objektivat/produktet për çdo program, për vitin 2023 - 2025 të programit buxhetor afatmesëm sipas tabelës 6,7,9 të FPT (Instrumentit të Planifikimit Financiar) dhe programeve buxhetore të detajuara , pjesë përbërëse e këtij vendimi.
  - e) Të miratojë listën e projekteve të investimeve publike, për çdo program, sipas tabelës 8 të FPT, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
  - f) Të miratojë fondet buxhetore, të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitet 2023-2025 , të ndara në korrente dhe kapitale; sipas tabelës 10 , pjesë përbërëse e këtij vendimi.
  - g) Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve në varësi për vitin 2023, sipas tabelës nr. 11, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Tabelat shoqeruese:
- a) Llogaritja e efektit financiar të lehtësimeve fiskale vendore, tabela nr.12, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
  - b) Lista e njësive shpenzuese të bashkisë Shkodër, sipas tabelës nr. 13 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
  - c) Një përmbledhje të të ardhurave, shpenzimeve dhe subvencioneve të shoqërive në pronësi të bashkisë, sipas tabelës nr. 14 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
  - d) Projektin e parë të planit të arkës të të ardhurave të veta të vitit 2023 dhe PBA 2023-2025 , sipas tabelës nr. 15 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
  - e) Një përmbledhje të pagesave të vonuara ndaj palëve të treta, përfshirë edhe origjinën e tyre dhe masat për likuidimin e parandalimin e krijimit të tyre, sipas tabelës nr. 16 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Fondet e papërdorura në fund të vitit 2022, me burim financimi nga transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike dhe të ardhurat e veta, do të jenë pjesë e buxhetit të vitit 2023.
4. Është kompetencë e Kryetarit të Bashkisë:
- a) Rishpërndarja e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program;
  - b) Rishpërndarja ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program;
  - c) Rishpërndarja brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njësive të ndryshme shpenzuese.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Bardh SPAHIA**

*Zv. Kryetar*

*Zv. Kryetar*

*Zv. Kryetar*

*Drejtoria e te Ardhurave*

*Drejtoria e Analizës dhe  
e Programimit Buxhetor*

*Drejtoria e Financës*

*Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndjekjes se  
investimeve të Infrastrukturës*

*Drejtoria Juridike*

*Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit*

*Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe  
Përmirësimit të Klimës së Biznesit*

*Drejtoria e Ndihmes Ekonomike dhe Personave  
me Aftësi Ndryshe*

*Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit*

*Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve  
Mbështetëse*

*Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit  
të Ujërave*

*Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe  
trajtimit të AMTP*

*Drejtoria e Studimeve, Planifikimit,  
Koordinimit të Investimeve*

---

*Drejtoria e Turizmit*

---

*Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të  
Territorit*

---

*Policia Bashkiake*

---

*Drejtoria e Administrimit të Sistemeve  
Menaxhimit të ZIN, Projekteve dhe  
Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit*

---